Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
ENERGY REGULATORY OFFICE
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
Nr. 936126
Data 05.11.26

Prishtinë, 23 tetor 2026
Kodi i ZRRE-së: V_3426 _2026

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Mbështetur në Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, Nenin 25, Nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe Nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.05/L-084); Nenin 19 paragrafin 2 të Rregullës Nr. 03/2022 për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Projekteve të Energjisë, Vendimi për Lëshimin e Autorizimit V_2803_2025 të datës 05 shtator 2025 për shoqërinë "EBE Energy" SH.P.K., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga panelet solare/fotovoltaike me kapacitet të instaluar prej 3 MW ZK Shtime, komuna e Shtimes dhe kërkesën për shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së Vendimit për Autorizim V_2803_2025 edhe për 12 (dymbëdhjetë) muaj, për vazhdimin e ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga panelet solare/fotovoltaike me kapacitet të instaluar prej 3 MW ZK Shtime, komuna e Shtimes, të datës 10.08.2026 nr. prot. 637/26 të shoqërisë "EBE Energy" SH.P.K., me adresë: Rr. "Ferid Curri", nr. 1 Prishtinë, Republika e Kosovës; dhe

në seancën e mbajtur më 23 tetor 2026 nxori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET** – kërkesa e shoqërisë "EBE Energy" SH.P.K., dhe **SHTYHET** afati i vlefshmërisë së autorizimit V_2803_2025 të datës 05 shtator 2025 për vazhdimin e ndërtimit e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga panelet solare/fotovoltaike me kapacitet të instaluar prej 3 MW ZK Shtimes, komuna e Shtimes.

II. **OBLIGOHET** - shoqëria "EBE Energy" SH.P.K., që brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të këtij Vendimi për vazhdim të afatit të vlefshmërisë së Vendimit V_2803_2025, që të dorëzoj garancionin financiar në vlerë prej 7% të vlerës së projektit, të lëshuar nga një Bankë Komerciale e licencuar apo kompani e sigurimeve në Republikën e Kosovës, me vlefshmëri që mbulon periudhën sipas Planin Dinamik të Realizimit të Aplikuesit.

III. Garancioni financiar sipas pikës II. të këtij Vendimi, do të jetë në vlerën prej 175,000.00€ (njëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë euro), sipas vlerës së projektit të prezantuar me Planin e Biznesit me rastin e aplikimit për Autorizim dhe duhet të mbulon periudhën deri **30.09.2028**.

IV. Kushtet tjera të vendosura me Vendimin V_2803_2025 mbesin të pa ndryshuara dhe duhet të zbatohen nga aplikuesi.

Arsyetim

- ZRRE, me datë 10.08.2026, nga "EBE Energy" SH.P.K., ka pranuar kërkesën për zgjatjen e afatit të vlefshmërisë së Autorizimit V_2803_2025 të datës 05 shtator 2025, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese fotovoltaike me kapacitet të instaluar prej 3 MW.

- Në kërkesën e saj, aplikuesi ka arsyetuar se gjatë realizimit të projektit është përballur me vonesa të konsiderueshme në procedurat e aprovimit të projektit dhe sigurimit të Leje-Hyrjes nga KEDS-i. Sipas aplikuesit, këto procedura kanë kërkuar kohë shtesë për shqyrtimin e dokumentacionit teknik, plotësimin e kërkesave dhe koordinimin me operatorin, duke ndikuar drejtpërdrejt në Planin Dinamik të Realizimit të projektit.

- Aplikuesi ka theksuar se procedurat pranë KEDS-it kanë filluar më 17.03.2025, ndërsa Pëlqimi Elektroenergjetik nr. 3001 është lëshuar më 03.06.2026 dhe Leje-Hyrja nr. 8527 më 11.06.2026. Sipas aplikuesit, vonesat në përfundimin e këtyre procedurave kanë qenë jashtë kontrollit të tij dhe kanë pamundësuar realizimin e projektit brenda afatit të paraparë.

- Gjithashtu, aplikuesi ka njoftuar se, përkundër vonesave procedurale, punimet në terren kanë vazhduar dhe pjesa dërrmuese e punimeve është realizuar. Si mbështetje të kërkesës ka dorëzuar dokumentacionin përkatës, përfshirë komunikimet me KEDS-in, Pëlqimin Elektroenergjetik, Leje-Hyrjen, Planin Dinamik të Realizimit dhe fotografi që paraqesin progresin e punimeve.

- Kërkesa për shtyrjen e afatit është bazuar në Nenin 19 paragrafi 2 të Rregullës Nr. 03/2022, sipas të cilit aplikuesi mund të kërkojë vazhdimin e afatit të autorizimit edhe për dymbëdhjetë (12) muaj të tjerë, kur arsyet e vonesës janë të arsyetuara dhe kanë qenë jashtë kontrollit të tij. Po ashtu, edhe Vendimi për Autorizim përcakton kushtet e realizimit të projektit dhe detyrimin për respektimin e Planit Dinamik.

- Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit mbështetës të dorëzuar nga aplikuesi, konstatohet se kërkesa është paraqitur duke u mbështetur në dispozitat e Rregullës Nr. 03/2022, ndërsa aplikuesi ka paraqitur dokumente dhe prova që synojnë të argumentojnë arsyet e shtyrjes së afatit dhe progresin e realizimit të projektit.

- Bordi i ZRRE-së, pas vlerësimit të kërkesës për shtyrje të afatit të Autorizimit, dëshmive të bashkangjitura, ka ardhur në përfundim se në aspektin administrativ dhe arsyeve faktike të prezantuara nga dëshmitë përkatëse duke pasur parasysh edhe vonesat kanë ardhur si rezultat i pengesave administrative, të cilat vonesa vlerësohen se janë jashtë kontrollit të aplikuesit, duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

V. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Driton Gojani, Kryesues

Arta Isufi, Anëtare

Adnan Preniqi, Anëtar

Lutfije Dervishi, Anëtare

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,
- Komunës së Shtimes,
- Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.